PHI LAN THR OPY

edicioni 1

hapësira e dedikuar
për FILANTROPINË

#philandthropy

kontakt :

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockfeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockfeller Brothers.

PHI
Land
THR
OPY

hapësira e dedikuar
për FILANTROPINË

Në këtë edicion

5 Rreth revistës

7 Të dhëna rreth aktivitetit filantropik

17 Java e Filantropisë 2020

Qershor - Dhjetor 2020

23
Intervista me përfaqësues të nismave filantropike në vend

Dea Buza
Grupi Balfin

34
Fushata në ndihmë të personave në nevojë

Qershor - Dhjetor 2020

37
Fondacionet Komunitare

Një risi për Shqipërinë

Rreth nesh

Mirë se erdhët në edicionin e parë të revistës Philandthropy!

Philandthropy është revista e parë në Shqipëri, e cila do të pasqyrojë çështje të ndryshme rreth nismave dhe zhvillimeve të aktivitetit filantropik në vend. Revista vjen në vijimësi të punës dhjetë vjeçare të Partnerëve Shqipëri mbi nxitjen dhe zhvillimin e këtij aktiviteti në vend duke vlerësuar rëndësinë që mbart për avancimin e shoqërisë.

Revista vjen online, me një numër të ri çdo gjashtë muaj duke sjellë në vëmendje të publikut shifra dhe fakte nga monitorimi i aktivitetit filantropik në vend, intervista me përfaqësues të sektorit të biznesit dhe individë, të cilët ndajnë eksperiencat e tyre mbi nismat e ndërmara; promovim të rasteve filantropike, studimeve dhe raporteve të realizuara në këtë fushë; si dhe një hapësirë e veçantë do t'i kushtohet fondacioneve komunitare duke nënvizuar rëndësinë e kësaj strukture për fuqizimin e komuniteteve vendore.

Revista është një platformë diskutimi dhe nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e rradhës, ju lutem shkruani tek kkeruti@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

GTX

7

TË DHËNA RRETH AKTIVITETIT FILANTROPIK

QERSHOR - DHJETOR 2020

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2020, të prezantuara në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe raportimin e rregullt mujor. Metodologjia e përdorur është bazuar në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës **qershor - dhjetor 2020**.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.
Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.



Numri i dhurimeve

- Monetare (86.84%)
- Mallra / Produkte (9.4%)
- Shërbime (2.26%)
- Miks (1.13%)
- Punë Vullnetare (0.38%)

Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë

Forma e dhurimit

Evente
16

266

Dhurime të drejtpërdrejta
114

Fushata për ngritjen e fondeve
136

Dhurime në grup



Dhurime individuale



Dhurime në grup

Dhurime individuale



Dhurime në grup



Dhurime individuale



Dhuruesit sipas Formës së dhurimit







**Dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera në secilën prej kategorive të "Formës së dhurimit".*

Fushata për ngritjen e fondeve

55 Thirrje për Dhurim

12 Fushata përmes medias vizive

41 Fushata përmes medias sociale

2 Fushata përmes medias sociale&vizive

21 Fushata përmes platformave Crowdfunding

5 Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*

Evente

14 Evente live

2 Evente online

**Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.*

Numri total i dhuruesve*



**Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.*

Vlera sipas natyrës së dhuruesit



3 DHURUESIT KRYESOR sipas numrit të dhurimeve

#1 Raiffeisen Bank Shqipëri
#2 Banka Amerikane e Investimeve
#3 Banka Credins

3 DHURUESIT KRYESOR sipas vlerës së dhurimeve

#1 Miks
Fushata për ngritjen e fondeve për Reinaldin, i cili vuante nga leuçemia

#2 Sigal Uniqa Group

#3 Miks
Fushata për ngritjen e fondeve për Tuanën, e cila vuante nga një formë e rrallë e anemisë

Përfituesit Përfundimtar

- Fëmijë dhe të rinjtë - Me aftësi të kufizuar (24.06%)
- Publik i gjerë - Vështirësi ekonomike (23.68%)
- Fëmijë dhe të rinjtë - Pa përkujdesje prindërore (21.05%)
- Gra dhe fëmijë - Viktima të dhunës dhe trafikimit (6.77%)
- Publik i gjerë - Zonë specifike (5.26%)
- Fëmijë dhe të rinjtë - Zonë specifike (4.14%)
- Të rritur - Me aftësi të kufizuar (4.14%)
- Fëmijë dhe të rinjtë (3.01%)
- Publik i gjerë (2.26%)
- Të rritur - Të moshuar (2.26%)
- Miks (1.5%)
- Mbrojtja e kafshëve (0.38%)
- Publik i gjerë - Komunitete minoritare (0.38%)
- Të rritur - Të pastrehë (0.38%)
- Të rritur - Prindër të vetëm (0.38%)
- Fëmijë dhe të rinjtë - Vështirësi ekonomike (0.38%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve



Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve




Diaspora
4.5%
Shtetas
të huaj
1.1%
Shqipëria
94%
5%
1%
Diaspora
Shtetas të huaj

Qëllimi i dhurimit

- Dhurime sezonale (25.56%)
- Mbështetje e grupeve të margjinalizuara (24.06%)
- Zbutja e varfërisë (19.92%)
- Shëndetësi (15.41%)
- Fatkeqësi natyrore (6.39%)
- Art dhe kulturë (3.76%)
- Edukim (2.26%)
- Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit (0.75%)
- Sipërmarrje Sociale (0.75%)
- Mbrojtja e kafshëve (0.38%)
- Shkencë (0.38%)
- Sport (0.38%)

Kanalet e dhurimit



Fjalorth

Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente – Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

Grup dhuruesish - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

Miks – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) – dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

PHILANTHROPY WEEK

make it the way to...

#bringChange

J A V A E F I L A N T R O P I S Ë

9 - 1 3 N Ë N T O R 2 0 2 0

Më 9 – 13 nëntor 2020, Partnerët Shqipëri organizoi për herë të parë eventin “Java e Filantropisë”. Ky event do të jetë një aktivitet i përvitshëm i cili do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit, promovimit, dhe debatit publik mbi çështje të aktivitetit filantropik në vend.

Eventi është konceptuar në organizimin e nje serie aktivitetesh ku vëmendja vihet tek solidariteti i individëve, shoqërisë civile, institucioneve publike dhe biznesit në ndihmë të komuniteteve në nevojë.

JAVA E FILAN





Forume diskutimi mbi rëndësinë e aktivitetit filantropik në vend

Gjatë javës së filantropisë u organizuan disa forume diskutimi mbi rëndësinë dhe promovimin e aktivitetit filantropik në vend, me pjesëmarrjen e disa institucioneve akademike, sektorit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile në vend.
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Ekonomisë, përfaqësues të lartë të Sigal Uniqa Group Austria, Banka Credins, Alpha Bank Albania ndanë opinione dhe histori suksesi mbi "Trendet e zhvillimit të aktivitetit filantropik në vend, në përballimin e situatës pandemike".

Pjesëmarrësit u njohën me disa nga nismat e ndërmarra nga vetë institucionet akademike, Sigal Uniqa Group Austria, Banka Credins, Alpha Bank Albania dhe Partnerët Shqipëri. Nga të gjithë përfaqësuesit u theksua se pavarsisht klimës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid – 19, kontributi ndaj grupeve në nevojë mbetet shumë i rëndësishëm në lehësimin e nevojave komunitare.

Në takime u ndanë shembuj të mbështetjes edhe për organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e shërbimeve si: Qendra Xhonatan dhe Down Syndrome Albania. Znj. Kita, drejtore e Qendrës Xhonathan theksoi rendesinë e këtij bashkëpunimi për ti shërbyer në vazhdimësi komuniteteve që targetojnë.

TROPISË 2020



Java e filantropisë në fokusin e medias

Pandemia dhe situatat e vështira që shoqëritë gjithnjë e më shumë përballen po nxisin gjithnjë e më tepër frymën e solidaritetit për të tjerët. E ftuar ne emision “Wake Up” në Top Channel, Zj. Kostandina Këruti, manaxhere programi e Partnerëve Shqipëri theksoi që “*Ky është viti i parë i organizimit të Javës së Filantropisë, duke organizuar një seri aktivitetesh për të sjellë në vëmendje të publikut e promovuar modele dhe praktika të aktivitetit filantropik në vend. Vitet e fundit vihet re një trend rritës së dhurimit të aktivitetit filantropik nga individët dhe shumë nisma që janë bërë pjesë e javës janë ndërmarrë nga individët, duke thyer mitin që filantropia ushtrohet vetëm nga familjet e pasura. Ne synojmë që ky aktivitet të jetë një aktivitet i përvitshëm dhe medium diskutimi publik midis grupeve të ndryshme të interesit, e veçanërisht për të rinjve dhe botës akademike, për ti përfshirë më tepër të rinjtë në aktivitete dhe nisma filantropike.”*



ka qenë barnatori dhe bamirësi më i njohur në Lezhë i cili kontribuoi gjatë gjithë jetës për zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve shëndetësore të qytetarëve dhe familjeve në nevojë në qytetin e Lezhës dhe më gjerë.

2 Të njihemi me pionerët e filantropisë

Një fushatë tjetër e organizuar gjatë Javës së Filantropisë, e cila kontribuoi në rritjen e informimit publik mbi figura të shquara shqiptare në këtë drejtim si dhe në rritjen e mirënjohjes publike për individë të cilët nuk jetojnë, por që kanë dhënë një kontribut të vyer për zhvillimin e edukimit, shëndetësisë, sportit, e në fusha të tjera. Përmes një kuizi të organizuar në median online, Partnerët Shqipëri promovoi dy figura të shquara si z. Vangjel Zhapa, dhe z. Hamza Rama.



ka dhënë kontributin e tij të vyer në fushën e arsimit, kulturës dhe sportit, ku vlen të përmendet financimi i abetares së parë shqipe të Naum Veqilharxhit dhe kontributi në përhapjen e gjuhës shqipe, ndërtimi i 135 shkollave në jug të vendit, si dhe ndërtimi i disa veprave publike brenda dhe jashtë Shqipërisë.



3 Fushata "Ndaj një vepër të mirë"

Fundi i vitit 2019 dhe viti që lamë pas shënoi një periudhë të vështirë për qytetarët shqiptarë të prekur nga pasojat e shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe ekspozimit dhe pasojat e lidhura me pandeminë e shkaktuar nga COVID -19. Një vit sa i vështirë aq edhe domethënës në inkurajimin dhe forcimin e solidaritetit dhe mbështetjes, në ndihmë të shtresave në nevojë. E për ti bërë jehonë praktikave të mira në këtë drejtim,

Nisma *"Ndaj një vepër të mirë"* promovoi raste të aktivitetit filantropik të ndërmarra nga individë, biznese dhe organizatat e shoqërisë civile në mbështetje të komuniteteve në nevojë në Shqipëri gjatë emergjencës së pandemisë globale. Gjashtë individë dhe biznese shfaqën interes dhe u përfshinë në këtë fushatë.

Klikoni **këtu** për të parë fushatën.

INTERVISTA ME PËRFAQËSUES TË NISMAVE FILANTROPIKE NË VEND

PANDEMIE

Të shumta kanë qenë dhurimet e forma të ndryshme të mbështetjes për kategoritë në nevojë gjatë pandemisë COVID -19. Mbështetje të ardhura nga institucione publike, kompani biznesi, organizata të shoqërisë civile por dhe individë. Në këtë edicion, vendosëm të promovojmë dy nismat si më poshtë vijon:

Dea Buza

FACE SHIELDMASK

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma Juaj dhe arsyet/ shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?

Nisma FaceShieldMask filloi në Mars 2020 në momentin që në Shqipëri dhe në Kosovë filluan të shfaqeshin rastet e para me COVID-19 dhe paralelisht filluan të merreshin masat për mbylljen. Duke ditur presionin e madh që do të kishte sektori i shëndetësisë si dhe nevojën për pajisje, filluam të mendonim si mund të kontribuonim për të lehtësuar sadopak situatën. Babai im, i cili është profesor i inxhinierise mekanike në Universitetin e Prishtinës, nga një koleg i tij, arriti të merrte një prototip të një maske “face shield” mbrojtëse e nivelit të dytë, prodhuar nga Universiteti i Valencias. Maskat prodhoheshin nëpërmjet printerit 3D dhe më pas ishin shumë të thjeshta per t`u montuar. Kishin nje kosto relativisht të vogël dhe ofronin një mbrojtje të plotë të fytyrës. Këto maska janë shumë të nevojshme për mjekët në vijën e parë të cilët kanë kontakte të drejtpërdrejta me personat, të cilët janë prekur nga COVID - 19. Të inspiruar edhe nga shumë lëvizje, të cilat po ndodhnin anembanë botës ku profesionistë të ndryshëm vunë në përdorim aftësitë e tyre për konceptimin dhe prodhimin e pajisjeve të ndryshme në ndihmë të stafeve mjekësore, dhe sidomos nga nevojat e sektorit të shëndetësisë në Kosovë dhe në Shqipëri vendosëm që të tentojmë të fillojmë prodhimin. Pasi testuam prototipin e parë dhe e konsultuam dhe me doktorët, përkatësisht Dr. Arben Gjatën, dhe na

u konfimua që ishte një pajisje e përshtatshme dhe e nevojshme, ne filluam të kontaktojmë me kolegë, të njohur, profesionistë, dhe persona që kishin printer 3D për të nisur prodhimin. Gjithcka u krye në mënyrë vullnetare dhe shumë persona na u bashkuan për të shtyrë përpara këtë nismë. Në Kosovë pati në një moment rreth 20 individë dhe kompani të ndryshme që ju bashkuan nismës për prodhimin e maskave, ndërkohë që në Shqipëri ishin rreth 5 grupe të cilët printonin.

Dicka interesante lidhet me faktin që duke qenë se në Shqipëri kishte më pak persona që disponinin printer 3D, ne kërkuam ndihmë dhe u mbeshtetëm financiarisht për blerjen e printerave dhe materialit. Mbështetja sërish ishte në formë dhurimi dhe vinte nga individë vullnet-mirë.

Cili ka qenë target grupi i mbështetuar dhe në cilat zona/ qytete është shtrirë mbështetja ?

Target grupi ynë kryesor kanë qenë mjekët në vijën e parë të shërbimit, e më pas vecanërisht mjekët, të cilët gjendeshin në spitale rajonale. Në Kosovë nisma ka arritur të prodhojë rreth 2000 maska, të cilat janë shpërndarë fillimisht në Prishtinë në spital dhe në ambulancën kryesore të qytetit, e më pas në të gjitha qytetet e spitalet e tjera rajonale si në Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj etj. Një proces i ngjashëm ndodhi edhe në Shqipëri, ku fillimisht u mbështetën Qendra Studentore Universitare Tiranë (QSUT) dhe spitali “Shefqet Ndroqi”, e më pas u mbështetën spitale rajonale në qytetin e Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Krujës, Fierit, Korcës, etj. Në të dyja rastet ne kemi ndjekur një qasje institucionale, pra nuk kemi shkuar ne drejtpërdrejtë në spital për të dorëzuar maskat, por jemi koordinuar me njësitë qendrore. Për shembull në Shqipëri kemi qenë gjithmonë në kontakt me operatorin e shërbimit shëndetësor, i cili na njoftonte për nevojat dhe për spitalet ku duheshin shperndarë maskat. Kjo gjë na ka ndihmuar shumë, pasi duke qenë në koordinim të vazhdueshëm me institucionet, ne arritëm që deri diku ti pergjigjeshim nevojave me produktin tonë modest.

TË PRODHUARA

MBI 3 500 MASKA

FACESHIELD

MASCK

Cili ka qenë impakti i arritur deri tani nga nisma?

Sic e përmenda dhe më parë, në Kosovë janë prodhuar mbi 2000 maska ndërkohë që në Shqipëri janë prodhuar 1500 maska. Duke qenë pajisje të cilat janë të ripërdorueshme, pra mund të dizinfektohen dhe më pas të ripërdoren nga mjekët apo infermierët mendoj që ka qenë një arritje e madhe. Gjithashtu, si në Kosovë ashtu dhe ne Shqipëri kryesisht ndihmat përqendroheshin në qendrat kryesore në Prishtinë dhe Tiranë, e kësisoj, ndihma që ne ofruam për spitalet rajonale besoj që ka dhënë një kontribut që edhe stafet mjekësore në këto spitale të kishin një mbrojtje më të përshtatshme. Ne, gjithashtu aplikuam dhe në një program ndërkombëtar organizuar nga 3D Hubs, i cili mbështeste spitale në të gjithë botën, dhe përfituam 1000 maska, po ashtu të printuara me printer 3D, të cilat u ndanë në Shqipëri dhe në Kosovë.

I gjithë procesi ka qenë shumë inspirues dhe shpresëdhënës. Nga mesazhet që kemi marrë, shumë persona janë inspiruar nga kjo nismë dhe kanë filluar të mendojnë sesi mund të vendosin aftësitë e tyre në shërbim të një kauze. Pra, edhe pse nuk jemi mjek, ne prapë kemi mundësi të kontribuojmë në këtë situatë, përtej faktit që duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos infektohemi. Gjithashtu, kjo ishte një mundesi e mirë për të hapur dhe një dritare të re në ndërlidhjen e teknologjisë me fusha të ndryshme. Përdorimi i gjerë i printerave 3D ka inspiruar dhe po inspiron shumë të rinj për të hyrë në këtë fushë.

Cili është plani juaj për të ardhmen?

Në vijim të nismës në Tiranë, ne aplikuam për një projekt tek LëvizAlbania. Projekti rezultoi fitues dhe tashmë jemi në fazën e zbatimit. Nëpërmjet projektit po ashtu jemi duke prodhuar maska, me një dizajn pak më të avancuar se ai fillestar, që prodhuam në kohë krize. Gjithashtu, kemi krijuar një prototip dhe po prodhojmë hapëse dyersh, të cilat vendosen tek doreza dhe mundësojnë hapjen pa prekje, por duke përdorur pjesën e brrylit. Kjo është një pajisje ndihmuese, e cila mund të aplikohet si në shkolla, ashtu dhe në qendra mjekësore për të reduktuar rrezikun e infektimit nëpërmjet prekjes. Nëpërmjet projektit të financuar nga Lëviz Albania do te prodhojmë 1000 maska dhe 500 hapëse dyersh. Gjithashtu, përmes këtij projekti organizuam dhe një konkurs për dizajner te rinj, ku morën pjesë 7 konkurentë me projekte shume interesante. Pra kjo eshte e ardhmja afat-shkurtër e nisëms sone. Në plane afat-gjata, eksperienca e nisur me FaceShield patjetër që ka qenë shumë inspiruese dhe ka hapur horizonte të reja. Modelimi dhe ofrimi i shërbimeve me printer 3D është një fushë shumë interesante të cilën besoj që do të vazhdoj ta ndjek. Eshtë një mundësi e mirë për të krijuar një qendër në Shqipëri për të mbështetur të rinj të talentuar, sic bëmë në rastin e konkursit modest, por edhe për të ofruar një alternativë për plotësimin e nevojave të ndryshme të shoqerisë, si dhe për të menduar më tej në fushën e inovacionit.

Grupi Balfin

AGIM FJOLLA

Drejtor i Komunikimit

Si lidhet kontributi dhe ndihma e ofruar me strategjine Tuaj në mbështetje të komuniteteve në nevojë gjatë këtij viti?

Grupi BALFIN gjithnjë i ka kushtuar një vëmendje dhe hapësirë të veçantë investimeve sociale në të mirë të shoqërisë dhe komuniteteve pranë. Për këtë arsye Grupi BALFIN ka ndërtuar një strategji të mirëmenduar sa i përket orientimit, qasjes dhe mënyrave sesi do të japë kontributin e tij në komunitet. Në përputhje me këtë strategji, çdo shoqëri e Grupit zhvillon një program vjetor përsa i përket projekteve të përgjegjësisë sociale. Departamenti i Komunikimit në zyrat qendrore të Grupit BALFIN bën planifikimin, vlerësimin, koordinimin dhe harmonizimin e gjitha nismave sipas shtyllave kryesore të projekteve sociale.

Viti 2020 nuk ka qenë një vit i zakonshëm për askënd. Që në muajt e parë të vitit, ndërkohë që mendonim akoma për efektet e tërmetit të 2019, u përplasëm fort me pandeminë që solli plot pasiguri. E gjithë shoqëria u vendos përballë kërcënimit dhe frikës për jetën ndërkohë që efektet ekonomike dhe sociale të pandemisë u ndien më shumë te shtresat “periferike” të shoqërisë, të cilat edhe pa pandeminë ishin të ekspozuar.

Nisur nga kriza e re që krijoi pandemia dhe sfidat me të cilat nuk ishim ndeshur më parë, thuajse të gjitha projektet e Grupit BALFIN në dobi të komuniteteve u rishkruan për t'ju gjendur më pranevojave të reja. Megjithatë, projektet për familjet e prekura nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019 nuk u ndërprenë por vijuan sipas parashikimeve. Projektet për të mbështetur të prekurit nga tërmeti ishin më të qarta pasi ishin vendosur që një vit me parë. Nën kujdesin e veçantë të Presidentit të Grupit BALFIN, Samir Mane, u dhuruar rreth 1.2 milionë euro vetëm për të dëmtuarit nga tërmeti.

Ndërkohë për pandeminë gjithçka është projektuar dhe zbatuar me "emergjencë". Megjithëse nuk ka qenë e lehtë për tu menaxhuar, kemi arritur të japim kontribut të konsiderueshëm me qëllim minimizimin e pasojave të pandemisë. Përtej nismave tona gjithashtu i jemi përgjigjur në kohë dhe në mënyrën e duhur thirrjes për ndihmë nga shumë komunitete të ndryshme në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe në vendet e tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor ku Grupi BALFIN është i pranishëm.

Cilat kanë qënë disa nga nismat e ndërmarra në vitin e fundit?

Ashtu si e përmenda edhe më sipër, viti 2020 ka qenë shumë i fokusuar te pasojat e pandemisë por pa mundur të harrohej edhe tërmeti i një viti më parë. Nevojat dhe kërkesat kanë qenë të shumta. Në ditët e para të pandemisë, kur akoma nuk e dinim se çfarë forme dhe përmase do të merrte, u fokusuam te ndihmat e shpejta, kryesisht në pako ushqimore apo maska dhe doreza mbrojtëse pasi gjithçka ishte e bllokuar. E përqendruam vëmendjen tonë te ato komunitete që ishin më në nevojë në periferi të Tiranës, në Kamëz, Burrel, Bulqizë, Elbasan, etj. apo te ata profesione që ishin të përballur më fort me emergjencën si policia apo mjekët.
Në momentin e dytë, kur kriza u bë pak më e parashikueshme dhe masat kufizuese më të lehta, nisëm fazën e dytë duke lëvizur drejt përmirësimit të infrastrukturës që të kishim mirëfunksionim të shërbimeve publike për sa më shumë qytetarë. Në bashkëpunim me institucionet publike, ishim të parët që mundësuam pajisjen e nxënësve në Tiranë me tabletë për të ndjekur mësimin online. Edhe fëmijët me sindromën Down mundën të ndiqnin programet arsimore dhe terapinë online falë laptopëve që arritëm të siguronim për ta.
E megjithatë, pavarësisht ndikimeve apo ndryshimeve që solli normaliteti i ri, ne nuk ndaluam dhënien e bursave të studimit, duke mbështetur dhe inkurajuar studentët ekselentë. Një tjetër projekt që ka patur impakt të madh në komunitet ka mobilimi i çerdhes së Bulqizës, e cila frekuentohet çdo ditë nga dhjetra fëmijë, të cilët gëzojnë tashmë ambiente më komode.

Përtej pandemisë dua të shtoj se Grupi BALFIN i ka në vëmendje të veccantë fëmijët dhe rritjen e tyre e shëndetshme dhe të sigurtë. Mbështetja e fushatës së ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj fëmijëve “Në Labirint” ishte një angazhim serioz i yni në këtë drejtim.
Ndër projektet e tjera me impakt në komunitet mund të përmendim edhe furnizimin me produkte ushqimore përgjatë gjithë vitit të një qendre sociale në Tiranë, dhurimi i veshjeve për qindra familje në nevojë, “Dhuro me Spar”, nisma për grumbullimin e ushqimeve për familjet në varfëri ekstreme, përkrahja e fushatës “Tungjatjeta” duke kontribuar për mundësimin e shërbimeve të specializuara në shtëpi për qindra fëmijë me aftësi të kufizuara, etj.

Jemi shumë krenar që pavarësisht vështirësive dhe rreziqeve që ky vit paraqiti për të gjitha shoqëritë e Grupit përkujdesja për komunitetet pranë nesh dhe shtresat më në nevojë nuk mungoi dhe nuk ishte asnjëherë në pikëpyetje.

Cili ka qenë impakti i kontributit Tuaj në përmirësim të komuniteteve?

Ne besojmë se rritja e një biznesi duhet të shoqërohet paralelisht me zhvillimin dhe rritjen ekonomike dhe sociale të komunitetit ku ai vepron. Ne sigurohemi që bizneset tona të shërbejnë njëkohësisht si investime për përmirësimin e kushteve të punës, infrastrukturës, kujdesit shëndetësor, edukimit dhe kulturës. Për vitin 2020 nuk kemi bërë akoma një analizë të të gjitha investimeve sociale por mund të them që gjatë vitit 2019 Grupi BALFIN ka kontribuar me rreth 1 milion euro në fusha si edukimi, mirëqënia e fëmijëve, shëndetësia, mjedisi dhe familjet në nevojë.

Ne përpiqemi që shoqëritë e Grupit BALFIN të mos kufizohen vetëm në ofrimin e vendeve të punës me standarde apo në përmirësimin e klimës ekonomike por të shkojnë më tej. Këto shoqëri bëhen pjesë e komuniteteve dhe ndihmojnë në përmirësimin e jetesës nëpërmjet investimeve sociale. Edhe vetë punonjësit e shoqërive të Grupit ndajnë të njëjtat vlera, dhe janë pjesëmarrës aktiv në nisma sociale duke kontribuar vullnetarisht për kauza të ndryshme.
Prej disa vitesh tashmë, Grupi BALFIN i është bashkuar Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara duke qenë promovues dhe kontribues tepër aktiv.

dhurime

Grupi Balfin

[redacted]

[redacted]

[redacted]

FUSHATA NË NDIHMË TË PERSONAVE NË NEVOJË

Fushata

disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve qershor - dhjetor 2020.

#1

1 Tetor, Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve! Në kuadër të kësaj dite, vullnetarët e degëve të Kryqit të Kuq zhvilluan veprimtari të ndryshme në ndihmë dhe mbështetje të moshës së tretë.

Dega e KK Tiranë vizituan të moshuarit dhe shpërndanë paketa ushqimore për familjet në nevojë. Ndërkohë Dega e KK Skrapar, qëndroi në qytetin e Poliçanit, në shtëpinë e të moshuarve, falë dhe mbështetjes së donatorit Z. Albert Zaimi. Në këtë ditë vullnetarët tanë apelojnë për më shumë vëmendje, përkujdes dhe dashuri për të moshuarit. Nën moton “Pleqëri pa vetmi” ftojmë komunitetin të kontribuojë për moshën e tretë.

PLEQËRI PA VETMI

#2

Solistët dhe Orkestra e TKOB sjellën gjatë muajit korrik 2020, një program tërësisht “kuq e zi”. Programi transmetoi pjesë nga kompozitorët shqiptarë, Prenk Jakova, Feim Ibrahimi e Tonin Harapi. Ky aktivitet u realizuar falë mbështetjes së Bankës Amerikane të Investimeve, i cili është edhe sponsor i përgjithshëm i TKOBAP.

T K O B

#RedforKids

#3

Fushata “Red for Kids”, e nisur nga Fondacioni “Vodafone Albania” po vijon misionin për t’u mundësuar fëmijëve të familjeve në nevojë në të gjithë Shqipërinë edhe më shumë akses në sistemin e mësimit online.

Gjatë muajit tetor 2020, Fondacioni Vodafone organizoi në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Kus”, Kashar, Tiranë eventin “Digjitalizim, për më shumë akses në arsim”, ku u prezantua dhurimi i 10,000 pajisjeve të tjera smart me qëllimin që askush të mos mbetet mbrapa në procesin mësimor.

Deri më tani Vodafone nëpërmjet #RedforKids ka kontribuar në 15,000 pajisje smart, një dhurim ky, nga më të rëndësishmit për sistemin arsimor në këto kohë të vështira për vendin. Të pranishëm në këtë event ishin Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Znj. Evis Kushi, Drejtori i Përgjithshëm i Vodafone Albania, Z. Achilleas Kanaris dhe Drejtoresha e AKSH-it, Znj. Mirlinda Karçanaj, si përfaqësues e mbështetës të këtij procesi digjitalizimi në sistemin arsimor në Shqipëri. Drejtori i Përgjithshëm i Vodafone Albania, Z. Achilleas Kanaris u shpreh se nisma ofron mundësi të barabarta qasjeje në edukim dhe informacion.

ME SHIKIM TË PARË

#4

Gjatë muajit tetor, Enkelejda Bregu Lopari realizoi ekspozitën “Me shikim të parë”. Ekspozita iu dedikua ndërgjegjësimit për Sindromën “Down”. Një pjesë e të ardhurave nga shitjet e pikturave iu dhurua fondacionit “Down Syndrome Albania” për të mbështetur shërbimet terapeutike të fëmijëve.

FONDACIONET KOMUNITARE

F O N D A C I O N E T K O M U N I T A R E

Menaxhere Programi tek Partnerët Shqipëri, dhe pjesë e Programit Nderkombëtar të Lidërve 2020, nga Graduate Center, City University New York (CUNY), Qendra për Filantropinë dhe Shoqërinë Civile, Kostandina Këruti, shpjegon arsyen se përse Partnerët Shqipëri adreson në mënyrë specifike zhvillimin e fondacioneve komunitare në Shqipëri. Ajo thekson trendin e fuqizimit të shoqërisë civile, rritjen e besimit dhe rritjen e filantropisë, gjë që ka bërë që Partnerët Shqipëri t`a konsiderojë këtë si një përparësi strategjike.

Në të gjithë botën, fondacionet komunitare po njihen si organizata të rëndësishme që i përgjigjen çështjeve të menjëhershme dhe afatgjata për dhe rreth komuniteteve. Ato mishërojnë vetë thelbin e "askush të mos mbetet pas". Fondacionet komunitare janë të afta të shfrytëzojnë pasuritë lokale, burimet njerëzore dhe të maksimizojnë kapitalin lokal; dhe të kontribuojnë në fuqizimin e komuniteteve që ato u shërbejnë dhe rritjen e rrjetëzimit ndërmjet individëve, institucioneve publike dhe private dhe entiteve të tjera për të zhvilluar dhe forcuar komunitetin.

Edhe pse fondacionet komunitare nuk janë zhvilluar ende, Shqipëria po dëshmon një fuqizim të shoqërisë civile. Institucionalisht, janë rritur kapacitetet në drejtim të menaxhimit, rolit drejtues, fushatave për ngritjen e fondeve dhe në katër vitet e fundit organizatat lokale kanë koordinuar dhe menaxhuar skemat e nën-kontraktimit duke mbështetur nismat lokale në nivel komunitar. Gjithashtu, shoqëria civile dhe organizatat e shoqërisë civile jo vetëm që po rriten në numër, por gjithashtu po formësojnë dhe ndikojnë në politikat lokale që u përgjigjen nevojave dhe përparësive të komunitetit, duke rritur besimin dhe ndikimin e tyre në shoqëri.

Bazuar në raportin vjetor të monitorimit të aktivitetit filantropik në vend të kryer nga Partnerët Shqipëri që nga viti 2015, vërehet një tendencë në rritje e aktivitetit filantropik në vend. Vitin e kaluar, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme si pasojë e tërmetit që goditi Shqipërinë,u konstatua një rritje me afërsisht 50% të thirrjeve për dhurim apo fushatave të organizuara nga individë dhe institucione.

Këto janë arsyet kryesore pse Partnerët Shqipëri përmes agjendës së saj synon të kontribuojë në rritje të ndërgjegjësit dhe edukimit më të gjerë të publikut mbi konceptin dhe modelin e fondacioneve komunitare. Nëse promovohen dhe organizohen si duhet, fondacionet komunitare mund të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave të komunitetit dhe organizatave jofitimprurëse në vend përmes fondeve të gjeneruara nga dhurimet lokale.

Partnerët Shqipëri do të përqendrohet në tre vitet e ardhshme në dy shtylla kryesore:

1 — *Rritja e ndërgjegjësimit dhe interesit publik për vlerat ekonomike dhe shoqërore të veprimtarisë filantropike përmes informimit, hulumtimit dhe promovimit të debatit publik në lidhje me të;*

2 — *Prezantimi dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për zhvillimin e platformave inovative që mundësojnë dhe lehtësojnë ndërveprimin midis aktorëve për zhvillimin e veprimtarisë filantropike me një fokus të veçantë mbi platformat on-line të ngritjes së fondeve dhe fondacionet komunitare.*

Konkretisht, në lidhje me fondacionet komunitetare, Partnerët Shqipëri do:

- të punojë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe mjeteve të edukimit mbi kuptimin, karakteristikat dhe impaktin e fondacioneve komunitare;
- të ndërmarrë hulumtime për të kuptuar më mirë karakteristikat e fondacioneve komunitare;
- të krijojë dialog dhe të ndërtojë ura lidhëse midis sektorëve për rritjen dhe zhvillimin e fondacioneve komunitare në vend.

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM
Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania